



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 3615 prot

Roskovec, më 29/04/2022

VENDIM
NR 27 DATË 28.04.2022
PËR HEQJEN E DEPOZITAVE TË UJIT NGA PALLATET E BANIMIT TË
DËMTUARA QË PARAQESIN RREZIK PËR JETËN DHE SHËNDETIN E
NJERËZVE

Në mbështetje të nenit 113 pika 2 të Kushtetutës; neni 8 pika 2, neni 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", neni 29, pika 3, neni 54, neni 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile", Ligjit nr. 10112, datë 16.06.2010, të këshillit të Ministrave "Për miratimin tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit", neni 7.1, shkronja "d" dhe neni 7.4, shkronja "a"; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Heqjen e depozitave të ujit nga tarracat, catitë e pallateve/banesave si edhe objekteve të shërbimit, në qytetin e Roskovecit, të cilat kanë shkaktuar dëmtime në objekt duke rrezikur jetën dhe shëndetin e banorëve dhe që nuk kanë ndjekur procedurën ligjore për tu pajisur me lejen përkatëse
2. Rast pas rasti sipas ankesave që paraqiten nga qytetarët, pas verifikimit nga specialistët përkatës që vërtetojnë se konstruksioni mbajtës i tarracës dhe i godinës në tërësi nuk lejon vendosjen e depozitave në tarracat e përbashkëta, heqja e depozitave të ujit të pijshëm që shkakton dëmtime në objekt, do të kryhet në mënyrë vullnetare nga pronarët e objekteve, ose në mungesë të tyre prej shfrytëzuesve aktual të ambienteve të banimit, të cilët kanë në përdorim këto depozita
3. Në rast mosveprimi, heqja e depozitave do të kryhet nga ana e bashkisë Roskovec, me anë të strukturave përkatëse.
4. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Policia Bashkiake, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria e Ujësjellës-Kanalizimeve Roskovec për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

